



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

U D H Ë Z I M

Nr. 2, datë 22.01.2016

PËR

“PËRCAKTIMIN E SASISË SË PULLAVE POSTARE NË RUAJTJE”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 46 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 34, të VKM-së nr. 1039, datë 16.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave për emetimin, prodhimin, dhe tregtimin e pullës postare shqiptare”,

U D H Ë Z O J:

Përcaktimin e sasisë së pullave postare në ruajtje si më poshtë:

1. Në “Muzeun e pullës postare shqiptare”, për çdo emision do të ruhen 100 seri/blloqe dhe 10 FDC (Zarf i Ditës së Parë, seri dhe bllok), nga 10 kopje për produktet filatelike si Kartpostare, Kartmax, si dhe nga 10 qarkore, të cilat në asnjë rast nuk mund të nxirren nga muzeu.
2. Në magazinën e pullave postare, 100 seri /bllok për çdo emision ruhen si rezervë e ministrit dhe përdoren për dhurata dhe raste të veçanta, vetëm me kërkesë me shkrim të tij, si dhe 100 seri (bllok), për çdo emision ruhen si rezervë e Drejtorisë së Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. Këto seri mund të përdoren për ekspozita, dhurata dhe raste të veçanta për shitje, vetëm me vendim të Drejtorisë së Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.
3. Çdo emision vjetor i pullave postare seri /bllok, i dërgohet “Bashkimit Postar të Përbotshëm”(UPU-së) për t’ua dërguar të gjitha administratave postare, anëtare të këtij unioni, sipas rregullave të përcaktuara nga UPU.
4. Posta Shqiptare sh.a, me vendim të Drejtorisë, ka të drejtë që një pjesë të emisioneve të pullave postare të vulosura, të shkurtra, FDC, Kartmax, t’i përdorë për qëllime filatelike, në raste të eventeve të ndryshme, për promovimin e pullës postare shqiptare.

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave

Tel: +355 4 2277355

E-mail: info@inovacioni.gov.al

5. Ngarkohet Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a. për zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Milena HARITO



Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave

Tel: +355 4 2277355

E-mail: info@inovacioni.gov.al